

Komuna e Shtërpcës 2017: Problemet kryesore dhe trendet buxhetore

Hyrje

Komuna e Shtërpcës bashkëqeveriset nga Partia e Pavarur Liberale Serbe (SLS) dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Kryetari i Komunës, Bratislav Nikolić, vjen nga radhët e SLS, kurse nënkryetari nga PDK.

Në zgjedhjet e kaluara komunale, kandidatët për kryetar kanë dhënë premtime të cilat nuk bien nën kompetencat vetanake të komunave. Megjithatë, hulumtimet tregojnë se qytetarët e Kosovës kanë njohuri të mjaftueshme mbi ndarjen e kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe lokal.¹ Mbi 82% e qytetarëve të Shtërpcës besojnë që pushteti lokal mund t'i zgjidhë të gjitha apo disa nga problemet me të cilat ballafaqohen ata në komunën e tyre.² Ndërsa sa i përket shkallës së kënaqshmërisë së qytetarëve të Shtërpcës me pushtetin lokal (Kryetarin e Komunës, Kuvendin Komunal dhe Administratën Komunale), del se ka një rënie të theksuar të kënaqshmërisë nga 31.74 pikë në vitin 2012 në 12.44 në vitin 2015.³

Në hulumtimin e zhvilluar nga Instituti GAP në fund të vitit 2013, problemet kryesore në këtë komunë në atë kohë kanë qenë derdhja e kanalizimit në lumin "Lepenc", mungesa e trotuarit në relacionin Drekoc-Firaj – Brod, pastaj mungesa e urës në shatin Brod, mungesa e terrenit sportiv në shkollën "Raymi Cakli", mungesa e çerdhes, dhe ndërtimet në zonën turistike Brezovica.

¹ Instituti GAP, Adresimi i Përgjegjësisë: Njohuritë e qytetarëve me kompetencat e komunave. Maj 2017. Burimi: <http://bit.ly/2os7GPU>

² Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 37. Burimi: <http://bit.ly/1d30foS> (Hapur më 21 qershor 2017)

³ Ibid. faqe 39

Problemet aktuale të Komunës së Shtërpçës

Derdhja e kanalizimeve në lumin "Lepenc"

Të gjitha kanalizimet fekale dhe atmosferike në Komunën e Shtërpçës derdhen në lumin "Lepenc". Derdhja e këtyre kanalizimeve vlerësohet të ndikojë në ndotjen e rrjedhës së lumit dhe në përhapjen e erës së keqe dhe insekteve. Kjo gjendje është e tillë edhe brenda qytetit të Shtërpçës, si dhe në fshatrat Kashtanjevë, Drekoc, Shushicë dhe Sevc.

Degradimi i pyjeve

Komuna e Shtërpçës është e njohur për pasuritë natyrore, sidomos pyjet e bukura dhe malet e larta të përshtatshme për zhvillimin e turizmit. Prerja e pyjeve shpesh bëhet prej vetë banorëve të kësaj komune. Por kohëve të fundit, këtë çështje e kanë diskutuar edhe në Kuvend Komunal që personat nga komunat tjera janë parë duke bartur drunj me traktor. Gjithashtu, ka dëmtime të pyjeve edhe në Parkun Nacional të Brezovicës e cila është kompetencë e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Pas aprovimit të ligjit, Ministria e ka pasur të planifikuar që ta hapë një drejtori për udhëheqjen e Parkut Nacional por kjo nuk ka ndodhur.

Mungesa e terrenit sportiv në shkollën "Razim Cakli"

Kjo shkollë nuk ka hapësirë të brendshme për ushtrimin e lëndës së edukatës fizike dhe aktiviteteve sportive. As në pjesën e jashtme nuk e ka të rregulluar terrenin sportiv. Fëmijët shpesh hasen duke luajtur në rrugën e asfaltuar që përshkohet nga automjetet e shumta.

Mungesa e çerdhes

Në Shtërpçë ekzistojnë dy çerdhe të cilat procesin edukativo-rekreativ e zhvillojnë vetëm në gjuhën serbe. Kjo ka bërë që vendbanimet e populluara me shqiptarë të mos mund të shfrytëzojnë shërbimin e çerdhes. Për të evituar këtë problem, kërkohet ndërtimi i çerdheve në fshatin Brod dhe në fshatin Firaj.


Ndërtimet në zonën turistike Brezovica

Ky problem vazhdon të jetë që nga viti 2009. Bashkëbiseduesit në këtë komunë kanë shfaqur shqetësimin e tyre me shkallën gjithnjë e në rritje nga ndërtimet në zonën turistike të Brezovices. Disa prej këtyre ndërtimeve janë bërë pa leje përkatëse komunale, duke dëmtuar hapësirat pyjore të kësaj ane.

Trendet buxhetore në Komunën e Shtërpcës Kosovës (2017)

Komuna e Shtërpcës në vitin 2017 ka planifikuar rreth 3.6 milionë euro buxhet.⁴ Përveç planifikimit të rregullt buxhetor Komuna e Shtërpcës ka bartur edhe rreth 110 mijë euro nga të hyrat e vitit të kaluar, ndërsa në vitin 2013 ishin bartur afro 96 mijë euro. Viti 2013 ka qenë viti kur kjo komunë ka pasur buxhet prej 3.3 milionë euro apo rreth 308 mijë euro më pak se vitin 2017.

Figura nr.1: Buxheti i Komunës së Shtërpcës 2017




Komuna e Shtërpcës nga viti 2013 ka pasur një dominim të shpenzimeve në paga, përderisa investimet kapitale kanë pasur lëvizje të ndryshme, gjatë viteve të fundit është shënuar rritje.

Ndërsa krahasuar me vitin 2013, numri i të punësuarve në Komunën e Shtërpcës është rritur për 30 persona në vitin 2016. Përveç numrit të rregullt të punëtorëve, në komunë janë punësuar 8 persona me kontratë për shërbime të veçanta dhe 2 janë punësuar jashtë listës së pagave gjatë vitit 2016.


⁴ Shih për më shumë platformën buxhetore të Institutit GAP në <http://bit.ly/2rMELbD>

Figura nr.2: Trendët buxhetore në Shtërpce 2013-2017



Komuna e Shtërpçës gjatë vitit 2016 ka pasur rritje të lehtë të arkëtimit të të hyrave vetanake komunale duke arkëtuar 260 mijë euro. Krahasuar me vitin 2013 kjo komunë ka realizuar rreth 100 mijë euro më shumë të hyra vetanake në vitin 2016.

Figura nr.3: Të hyrat komunale 2013-2016



Burimi: Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Rekomandimet

Duke u bazuar në problemet kryesore, fushat të cilat kërkojnë vëmendjen e Komunës dhe trendet buxhetore, Instituti GAP rekomandon që qeverisja e komunës e dalë nga zgjedhjet lokale të 2017 të ndërmerr këto veprime:

- Komuna duhet të ndërmarrë masa për të parandaluar çfarëdo ndërtimit pa leje në zonën turistike të Brezovicës.
- Komuna duhet të sigurojë fonde për të trajtuar çështjen e ujërave të zeza, veçmas evitimin e derdhjes së tyre në lumin e qytetit.
- Komuna duhet urgjentisht t'i shtojë masat e saj në parandalimin e prerjes së mëtutjeshme në formë ilegale të pyjeve.
- Komuna duhet t'i shtojë investimet në rritjen e hapësirave rekreative-sportive.

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE



Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Ky projekt mbështetet nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world